

Tekst i konsoliduar jozyrtar¹

Në bazë të nenit 158-s pika 1) dhe në lidhje me nenin 134-gj të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 27/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010, 44/2011, 188/2013, 43/2014, 112/2014, 153/2015, 192/2015 dhe 23/2016), Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve në mbledhjen e mbajtur më 10.3.2017, solli

R R E G U L L O R E **për dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejes për kryerje të** **aktiviteteve/veprimtarive të përfaqësimit në sigurime**

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e lejes për kryerjen e aktiviteteve të përfaqësimit në sigurim nga ana e Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimeve (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia), në përputhje me Ligjin e Mbikëqyrjes e Sigurimeve (në tekstin e mëtejshëm: Ligji):

Dokumentacioni i nevojshëm i cili i bashkangjitet kërkesës për marrjen e lejes për kryerje të aktiviteteve të përfaqësimit në sigurim

Neni 2

(1) Për dhënien e lejes për kryerjen e veprimtarive/aktiviteteve të përfaqësimit në sigurim në Agjenci dorëzohet kërkesë për marrjen e lejes për të kryer veprimtari ose punë të përfaqësimit në sigurim.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni do të dorëzohet ekskluzivisht në formularin e paraparë: "Kërkesë për marrjen e lejes për kryerjen e veprimtarive/aktiviteteve të përfaqësimit në sigurim (Formulari K-MLP)" i cili është bashkangjitur si Aneksi 1 i kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni i bashkëngjitet dokumentacioni vijues:

1. Propozim-statuti që duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:

- kompania (firma) dhe selia e kompanisë për përfaqësim në sigurime;
- shuma e kapitalit fillestar aksionar të agjencisë për përfaqësim në sigurime;
- shuma nominale e aksioneve, numri i aksioneve për secilën gjini dhe klasë, të drejtat, detyrimet, kufizimet dhe përfitimet që rrjedhin nga aksionet;
- mënyra e marrjes dhe e përfundimit të të drejtave të aksionarëve të shoqërisë për përfaqësim në sigurime;
- procedura për konvokimin dhe mbajtjen e Kuvendit të Aksionarëve të shoqërisë/kompanisë për përfaqësim në sigurim;
- lloji, përbërja, numri, mënyra dhe kushtet e zgjedhjes, afati, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të organeve të shoqërisë për përfaqësim në sigurim;
- mënyra e administrimit të shoqërisë dhe përfaqësimit nga ana e anëtarëve të organit drejtues

¹ Teksti i konsoliduar i Rregullores është përgatitur në bazë të tekstit të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejes për të kryer aktivitete/veprimtari të përfaqësimit në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 35/2017) dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejes për të kryer punë ose veprimtari të përfaqësimit në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/2019). Teksti përfundimtar nuk ka fuqi ligjore. Për qëllime juridike, në procedurën e dhënies së lejeve valide janë vetëm tekstet të cilët janë botuar në Gazetat e lartpërmendura Zyrtare.

- të shoqërisë për përfaqësim në sigurime;
 - numri, mandati, të drejtat, përgjegjësitë dhe kushtet për emërimin e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në shoqërinë për përfaqësim në sigurime;
 - mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet aksionarëve të kompanisë për përfaqësim në sigurime;
 - mënyra e zgjidhjes së konflikteve të interesit dhe ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave të kompanisë për përfaqësim në sigurime;
 - forma dhe mënyra e publikimit të të dhënave nga agjencia për përfaqësime në sigurime;
 - kushtet dhe rastet e përfundimit të aktivitetit të shoqërisë për përfaqësim në sigurim dhe
 - të dhëna të tjera sipas ligjit.
2. Plani i punës së kompanisë/shoqërisë për përfaqësim në sigurime, i cili duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:
- bazat e politikës tregtare të kompanisë për përfaqësim në sigurime me arsyetim, gjegjësisht analizë të arsyeve për themelimin e kompanisë për përfaqësim dhe objektivat tregtare të kompanisë për përfaqësim në sigurime dhe shqyrtimin e tregut në të cilën do të marrë pjesë kompania për përfaqësim në sigurime, strukturën e klientëve të kompanisë për përfaqësim në sigurime;
 - vëllim të planifikuar të kostove/shpenzimeve për themelim, kostove organizative dhe kostove të zhvillimit;
 - raport me parashikim të rezultateve të pritura tregtare për të paktën një periudhë tre-vjeçare, kryesisht në lidhje me të ardhurat e pritura nga provizionet, shpenzimet e pritura, fitimin e pritur dhe të tjera. Raporti duhet të përfshijë: (1) Bilanc të detajuar të gjendjes, Bilanc të të Ardhurave dhe Bilanc të Fluksit të Parave me koment për secilin pozicion dhe supozimet themelore mbi të cilat mbështetet parashikimi, (2) lëvizjen e treguesve financiarë, siç janë treguesit e likuiditetit, rentabiliteti dhe cilësisë së aktiveve;
 - përshkrim të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm;
 - selia e shoqërisë për përfaqësim në sigurime, si dhe numrin dhe vendndodhja e mundshme të filialeve dhe pjesëve të tjera, si dhe koha kur kompania për përfaqësim në sigurim synon t'i hapë ato;
 - struktura organizative e kompanisë për përfaqësim në sigurim, me një përshkrim specifik të fushëveprimit dhe përgjegjësi të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të secilës njësi organizative, marrëdhëniet mes tyre dhe marrëdhëniet me organet drejtuese dhe mbikëqyrëse të shoqërisë, si dhe përshkrim të numrit të nevojshëm të punonjësve dhe strukturën e kualifikimit të tyre;
3. Dëshmi se janë paguar mjetet monetare në emër të kapitalit aksionar të shoqërisë për përfaqësim në sigurim në një llogari të veçantë të përkohëshme të bartësi i operacioneve të pagesave, gjegjësisht në llogari devizore në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë (për themeluesin person juridik gjegjësisht fizik të huaj);
4. Listë e aksionarëve të shoqërisë për përfaqësim në sigurime, duke shënuar emrin dhe mbiemrin, vendbanimin dhe adresën e personave fizikë-themelues, gjegjësisht emrin (titullin) dhe selinë e personave juridikë-themelues, si dhe të dhënat për shumën totale nominale të aksioneve të mbajtura dhe përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin aksionar për përfaqësim në sigurime;
5. Bazat e politikës tregtare të kompanisë për përfaqësim në sigurime me arsyetim, gjegjësisht analizë të arsyeve për themelimin e kompanisë për përfaqësim në sigurime, objektivat tregtare të kompanisë për përfaqësime në sigurime, shqyrtimin e tregut në të cilën do të marrë pjesë kompania për përfaqësim në sigurime, strukturën e klientëve të kompanisë për përfaqësim në sigurim dhe të dhëna të tjera;
6. Tarifa për shërbimet e kryera të agjencisë për përfaqësim në sigurime;
7. Dokumentacion mbi bazën e të cilit mund të konkludohet se kompania për përfaqësim në sigurim

është e pajisur në aspektin kadrovik, teknik dhe organizativ për kryerjen e veprimtarive të parashikuara me statutin e shoqërisë, me të dhëna për sistemin informatik dhe gatishmërinë teknike të kompanisë për përfaqësim në sigurime;

8. Kontratë ose parakontratë për përfaqësim në sigurime, e lidhur me kompaninë e autorizuar të sigurimit, e cila duhet të përmbajë një dispozitë për mbikëqyrje të përhershme të shoqërisë së sigurimeve mbi zbatimin e kontratës;
9. Kontratë ose parakontratë të sigurimit nga përgjegjësia, e lidhur me një kompani të autorizuar për sigurime në Republikën e Maqedonisë;
10. Program për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
11. Të dhëna për personin që do të punësohet në shoqërinë ose kompaninë për përfaqësim në sigurim, me dëshmi që personi plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, së bashku me një letër për qëllimet për lidhjen e kontratës për punësim të përfaqësuesit në sigurime, të nënshkruar nga themeluesit e kompanisë për përfaqësim në sigurim dhe e noterizuar ose parakontraktë për angazhimin e përfaqësuesit në sigurim, të lidhur midis themeluesit (ëve) dhe përfaqësuesit në sigurime;
12. Vërtetim për tarifën e paguar për dhënien e lejes për kryerjen e veprimtarive/aktiviteteve të përfaqësimit në sigurime, sipas Tarifës së Agjencisë.

(4) Nëse personi i cili synon të themelojë shoqëri ose kompani për përfaqësim në sigurime është person fizik, atëherë përveç dokumentacionit të përmendur në paragrafin (3) të këtij neni, bashkangjitur me kërkesën për marrjen e lejes për kryerje të veprimtarive/punëve të përfaqësimit në sigurime dorëzohet edhe:

1. Pyetësori i plotësuar për persona fizikë në një formular të përshtatshëm të përcaktuar i cili jepet në Shtojcën 3 të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri ose kompani të sigurimit, shoqëri ose kompani të brokerimit në sigurim, gjegjësisht shoqëri për përfaqësim në sigurime dhe është pjesë përbërëse e tij. Plotësohen të dhëna (emër dhe mbiemër, vendbanimi dhe numëri i letërnjoftimit) për personin fizik të marra nga letërnjoftimi, gjegjësisht dorëzohet kopje e pasaportës për personin fizik të huaj. Bashkangjitur me të dhënat për personin fizik, të marra nga letërnjoftimi, dorëzohet deklaratë nga personi se ato janë të dhënat e tij dhe janë të sakta, të vërtetuara nga ana e personit të autorizuar (noterit);
2. Burimet e mjeteve për pagesën e kapitalit, dhe atë:
 - 2.1 Deklaratë e personit fizik për prejardhjen e mjeteve që investohen si kapital aksionar të shoqërisë ose kompanisë për përfaqësim në sigurim gjegjësisht baza për marrjen e aksioneve në shoqëri ose kompani;
 - 2.2 Dëshmi e duhur për burimin e mjeteve të cilat personi fizik i investon në kompaninë për përfaqësim në sigurime me shumë së paku të barabartë me vlerën nominale të aksioneve të cilat janë lëndë ose subjekt i marrjes (vërtetim për të ardhurat e realizuara, i lëshuar nga organi i autorizuar tatimor, dokument për shumën e rrogës dhe të ardhurave të realizuara në baza të tjera, vërtetim për trashëgimi, vërtetim nga banka ose ndonjë institucion tjetër financiar për shumën dhe datën e mjeteve të investuara dhe dëshmi tjetër të përshtatshme);
3. Vërtetim nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë ose ndonjë regjistër tjetër publik që nuk ka sanksione kundërvajtëse ose ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës në fushën e sigurimeve dhe financave;
4. Vërtetim nga procesverbali penal i gjykatës kompetente se personi nuk është dënuar me aktgjykim gjyqësor fuqiplotë me dënim me burg pa kusht për më shumë se gjashtë muaj, për sa kohë që zgjasin pasojat juridike të vendimit, për vepra penale kundër patundshmërisë, vepra penale kundër financave publike, operacioneve të pagesës dhe ekonomisë, vepra penale ndaj detyrës, si dhe vepra penale falsifikim i dokumenteve, raste të veçanta të falsifikimit të dokumenteve, falsifikim kompjuterik, përdorimi i dokumenteve me përmbajtje të pavërtetë si dhe mosrespekti ndaj të Drejtës Penale.

5. Deklaratë nga personi fizik, se tre vitet e fundit nuk ka kryer funksionin e një personi me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në kompani të sigurimeve ose ndonjë person tjetër juridik ndaj të cilit është zbatuar administratë speciale, ose kundër të cilit janë filluar procedurat e falimentimit ose të likuidimit;
6. Deklaratë nga personi fizik se është i njohur me dispozitat e Ligjit për mbikëqyrjen e sigurimeve sipas të cilave personi nuk duhet të jetë i lidhur me personin juridik, në të cilin kompania për përfaqësim në sigurime drejtpërdrejt ose indirekt posedon më shumë se 10% të kapitalit ose të drejtave të votimit në atë person juridik;
7. Deklaratë e personit fizik se personi fizik nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
8. Vërtetimi për mos ekzistimin e lidhshmërisë kapitale ose drejtuese të personit fizik me kompanitë e sigurimit, kompanitë e brokerimit në sigurime dhe kompanitë e tjera për përfaqësim në sigurime në përputhje me nenin 16-a të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, si vijon:
 - 8.1 Deklaratë nga personi fizik se nuk është person i lidhur me kompani të sigurimit, me kompani të brokerimit në sigurim dhe me kompani të tjera të përfaqësimit në sigurim sipas nenit 16-a të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve;
 - 8.2 Listë e personave juridikë në të cilët personi fizik posedon drejtpërdrejt ose indirekt më shumë se 10% të aksioneve, d.m.th. pjesë, e nënshkruara nga personi fizik;
 - 8.3 Dëshmi nga Regjistri Qendror i Letrave me Vlerë ose ndonjë regjistër tjetër publik se te cilët persona të tjerë juridikë personi fizik posedon aksione;
 - 8.4 Dëshmi nga Regjistri Qendror ose ndonjë regjistër tjetër publik se ku personi fizik posedon pjesë (aksione) në persona të tjerë juridikë;
 - 8.5 Vërtetim nga Regjistri Qendror ose ndonjë regjistër tjetër publik, për atë se ku është personi fizik anëtar i një organi drejtues, i një organi mbikëqyrës, prokurues ose person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në persona të tjerë juridikë;
9. Dëshmi të tjera për vlerësimin e bonitetit të personit fizik.

(5) Nëse personi i cili synon të themelojë shoqëri ose kompani për përfaqësim në sigurim është person juridik, atëherë përveç dokumentacionit të përmendur në paragrafin (3) të këtij neni, bashkangjitur me kërkesën për marrjen e lejes për kryerje të veprimtarive/punëve të përfaqësimit në sigurim dorëzohet edhe:

1. Pyetësori i plotësuar për persona juridikë me formularë të volitshëm të përcaktuar i cili jepet në Shtojcën 2 të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri ose kompani të sigurimit, shoqëri ose kompani për brokerim në sigurim, gjegjësisht shoqëri për përfaqësim në sigurime dhe është pjesë përbërëse e tij;
2. Vendim i organit kompetent të personit juridik, për pjesëmarrje në themelimin e kompanisë/shoqërisë për përfaqësim në sigurim, i sjellë nga organi kompetent i personit juridik;
3. Burimet e mjeteve për pagesën e kapitalit, dhe atë;
 - 3.1 Deklaratë e organit kompetent të personit juridik për prejardhjen e mjeteve që investohen si kapital aksionar në shoqërinë ose kompaninë për përfaqësim në sigurim, gjegjësisht baza për marrjen e aksioneve në shoqërinë ose kompaninë e përfaqësimit në sigurim dhe
 - 3.2 Dëshmi adekuate për burimin e fondeve që personi juridik i investon në shoqërinë për përfaqësim në sigurim me shumë të paktën të barabartë me vlerën nominale të aksioneve që i nënshtrohen përvetësimit ose përfitimit (raport auditimi i personit juridik, bilanc ose dëshmi tjetër e përshtatshme);
4. Vërtetim nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë ose ndonjë regjistër tjetër publik që kundër personit juridik nuk ka sanksione kundërvajtëse ose ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës në fushën e sigurimeve dhe financave;
5. Vërtetim nga Regjistri qendror ose ndonjë regjistër tjetër publik që konfirmon se personit juridik nuk i është shqyptuar asnjë dënim dytësor dhe atë ndalesë për marrjen e lejes për themelimin dhe punën e kompanisë së sigurimit, anulim të lejes për themelimin dhe punën e

- kompanisë së sigurimit, ndalesë për themelimin e personave të ri juridikë dhe ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerjen e veprimtarive të sigurimit;
6. Dëshmi se nuk ka filluar procedurë falimentimi ose likuidimi ndaj personit juridik, si vijon:
 - 6.1 Vërtetim nga Regjistri qendror ose ndonjë institucion tjetër kompetent se asnjë veprim i falimentimit ose likuidimit nuk është filluar kundër personit juridik;
 - 6.2 Deklaratë nga organi kompetent i personit juridik se kundër personit juridik nuk ka filluar procedurë falimentimi ose procedurë likuidimi;
 7. Deklaratë nga organi kompetent i personit juridik, se është i njohur me dispozitat e Ligjit për mbikëqyrjen e sigurimeve sipas të cilave personi nuk duhet të jetë i lidhur me personin juridik, në të cilin kompania për përfaqësim në sigurim drejtpërdrejt ose indirekt posedon më shumë se 10% të kapitalit ose të drejtave të votimit në atë person juridik;
 8. Deklaratë e organit kompetent të personit juridik, se personi juridik nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
 9. Dëshmi për mosekzistimin e lidhshmërisë kapitale ose drejtuese të personit juridik me kompanitë e sigurimit, kompanitë e tjera të përfaqësimit në sigurim ose kompanitë e brokerimit në sigurim në përputhje me nenin 16-a të Ligjit për Mbikëqyrjen e sigurimeve, si vijon:
 - 9.1 Deklaratë nga organi kompetent i personit juridik, se personi juridik nuk është person i lidhur me kompani të sigurimit, me kompani të tjera të përfaqësimit në sigurime, gjegjësisht kompani të brokerimit në sigurime sipas nenit 16-a të Ligjit për Mbikëqyrjen e sigurimeve;
 - 9.2 Dëshmi nga Regjistri Qendror i Letrave me Vlerë, gjegjësisht nga ndonjë regjistër tjetër publik lidhur me atë se kush janë bartës të aksioneve, gjegjësisht kush ka pjesë/aksione në personin juridik;
 - 9.3 Listë e personave juridikë në të cilët personi juridik posedon drejtpërdrejt ose indirekt më shumë se 10% të aksioneve, d.m.th. pjesë, e nënshkruar nga personi i autorizuar i personit juridik;
 - 9.4 Dëshmi nga Regjistri Qendror i Letrave me Vlerë ose ndonjë regjistër tjetër publik se te cilët persona të tjerë juridikë personi juridik posedon aksione;
 - 9.5 Dëshmi nga Regjistri qendror, respektivisht ndonjë regjistër tjetër publik se ku personi juridik posedon pjesë në persona të tjerë juridikë;
 10. Akti për themelim gjegjësisht Statuti i personit juridik;
 11. Listë e anëtarëve të organit drejtues të personit juridik (Certifikatë nga Regjistri qendror ose ndonjë regjistër tjetër relevant publik);
 12. Certifikatë nga regjistri në të cilin është regjistruar personi juridik;
 13. Kopje e librit të aksioneve;
 14. Raport revizor/auditiv (Raport për revizionin e kryer të pasqyrave financiare të kompanisë) i përpiluar nga kompania e autorizuar për auditim për dy vitet e fundit të punës për personin juridik. Personat juridikë të cilët janë themeluar dhe operojnë për më pak se dy vite detyrohen të dorëzojnë Raport të revizionit ose auditimit të kryer për pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën për të cilën kanë punuar, me gjendje me datë më së shumti një muaj para dorëzimit të kërkesës për marrjen e lejes, si dhe të dorëzojnë raporte revizore për dy vitet e fundit afariste për aksionarët e tyre-persona juridikë, d.m.th. të dorëzojnë dokumentacionin përkatës të paragrafit (4) të këtij neni për aksionarët e tyre - persona fizikë, të cilët marrin pjesë në kapitalin e personit juridik me mbi 10%;
 15. Dëshmi të tjera për vlerësimin e aftësisë pagueuse (bonitetit) të personit juridik, si dhe vlerësimin e aksionarëve të tij, d.m.th. të mbajtësve të aksioneve.

(6) Përveç dokumentacionit të përmendur në paragrafin (3), (4) dhe (5) të këtij neni, Agjencia mund të kërkojë dokumentacion tjetër shtesë, i cili mund t'i referohet në veçanti por jo vetëm dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve vijuese:

- bilanc ose pasqyrë e gjendjes së llogarisë bankare për një periudhë të caktuar, që ka të bëjë me

- personin i cili synon të themelojë kompani për përfaqësim në sigurime;
- të dhëna për statusin juridik, gjendjen financiare dhe strukturën e pronësisë së personave që kanë pjesëmarrje të kualifikuar në personin (subjektin) që synon të themelojë kompani të përfaqësimit në sigurim;
- të dhëna për përbërjen e grupit sigurues, bankar ose ndonjë grupi të llojit tjetër, nëse personi që synon të themelojë kompani ose shoqëri të përfaqësimit në sigurime është anëtar i një grupi të tillë, me listë të subjekteve individuale të grupit dhe përshkrim të lidhshmërisë ose marrëdhënieve të tyre;
- pasqyra të reviduara financiare të anëtarëve të tjerë të grupit të sigurimeve, bankare ose të grupit të llojit tjetër, nëse personi që synon të themelojë kompani të përfaqësimit në sigurime është anëtar i një grupi të tillë, ose të personave të tjerë të lidhur me personin që synon të themelojë kompani të përfaqësimit në sigurim, puna e të cilit mund të ketë një ndikim në punën dhe / ose rreziqet ndaj të cilave do të ekspozohet kompania e përfaqësimit në sigurime.

(7) Dokumentacionin nga paragrafi (4) pika 8) nënpikat 8.3, 8.4 dhe 8.5, paragrafi (5) pikat 6) nënpikat 6,1, pika 9) nënpikat 9.2, 9.4 dhe 9.5 si dhe pikat 12) dhe 13) të këtij neni, Agjencia do ta marrë me detyrë zyrtare nga organi publik kompetent (nëse i njëjti nuk dorëzohet nga kërkuesi), për të cilin kërkuesi do të bëjë një deklaratë që autorizon Agjencinë në emër të tij/saj dhe në llogari të tij/saj t'i përdorë të dhënat që përmbahen në formularin K-MLP (Deklarata është një pjesë përbërëse e Formularit K-MLP) i cili është dhënë në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje dhe në Agjenci të dorëzojë dëshmi për pagesën e kryer në llogarinë e institucionit përgjegjës për lëshimin e dokumentit të duhur me shumën e përcaktuar nga Tarifa e përcaktuar me ligj.

(8) Vërtetimin nga paragrafi (4) pika 4 e këtij neni, Agjencia zyrtarisht do ta marrë nga gjykata përkatëse kompetente (nëse i njëjti nuk paraqitet nga kërkuesi). Nëse personi është person i huaj, ai / ajo është i detyruar të sigurojë vetë informacionin e tillë nga autoritetet kompetente në vendin e huaj .

(9) Me aftësinë e përshtatshme organizative të kompanisë ose shoqërisë së përfaqësimit në sigurim në pikëpamje të paragrafit (3) pika 7) të kësaj rregulloreje nënkuptohet themelimi i një organizimi të tillë të kompanisë për përfaqësim ku do të mundësohet kryerja me sukses e veprimtarisë së saj sipas vëllimit të specifikuar në Statut dhe Planin e Punës, që vërtetohet me sjelljen e projekt-akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, vendimin për organizimin e njësive të punës, rregulloret e punës së revizionit ose auditimit të brendshëm, etj.

(10) Me aftësi të përshtatshme teknike të kompanisë së përfaqësimit në sigurim në pikëpamje të paragrafit (3) pika 7) e kësaj rregulloreje nënkuptohet:

- 1) hapësirë tregtare për kryerjen e veprimtarive/aktiviteteve të përfaqësimit në sigurim që plotësojnë standardet e kërkuara në lidhje me numrin e planifikuar të të punësuarve;
- 2) projekt për zbatimin e pajisjeve të përshtatshme informatike dhe zgjidhjen softuerike për kryerjen e veprimtarive/aktiviteteve të përfaqësimit në sigurime, të cilat sipas vëllimit dhe karakteristikave teknike korrespondojnë me numrin e të punësuarve dhe vëllimin e planifikuar të punës së kompanisë për përfaqësim në sigurime.

(11) Me aftësi të përshtatshme kadrovike të kompanisë për përfaqësim në sigurim në kuptimin e paragrafit (3) pika 7) të kësaj rregulloreje nënkuptohet struktura e parashikuar e kualifikimit të punonjësve me stazhin dhe përvojën e nevojshme të punës për secilin pozicion specifik pune, si dhe dinamika e planifikuar për plotësimin e vendeve të punës, e cila duhet të ndjekë dinamikën e rritjes së vëllimit të punës dhe zgjerimit të rrjetit organizativ të kompanisë së sigurimeve. Është e nevojshme të tregohet numri i të punësuarve sipas njësive individuale organizative, të dhëna për arsimimin e personave që do të përfshihen në kryerjen e veprimtarive financiare dhe plani për trajnimin e të punësuarve për tre vitet e ardhshme. Nëse është e nevojshme, gjithashtu dorëzohet një plan për të arritur numrin e planifikuar të të punësuarve.

(12) Projekti për implementimin e sistemit informatik duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të infrastrukturës së parashikuar të harduerit dhe softuerit, specifikimin e pajisjeve dhe funksionalitetet e aplikacionit, planin për zbatimin me hapa dhe afate të përcaktuara, përshkrim të masave të sigurisë që do të zbatohen si dhe mënyra në të cilën do të sigurohet vazhdimësia e shërbimeve. Projekti duhet të marrë parasysh standardet e pranuar përgjithësisht për sigurinë e sistemit informatik dhe për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit, përveç nëse parashihet ndryshe nga Agjencia. Nëse parashikohet që funksionimi i sistemit informatik të varet nga furnizues të jashtëm (kompani për shërbime ndihmëse), kompania për përfaqësim në sigurime duhet të përfshijë dokumentacionin e duhur të marrë nga furnizuesi në vetë projek-planin e tij, me çka do të definohet shumë qartë sasia dhe cilësia e shërbimeve, masat e sigurisë, si dhe karakteristikat e dërgesës.

(13) Dokumentacioni për pajisjet teknike duhet të përmbajë të dhëna për hapësirën tregtare ku do të operojë agjencia për përfaqësim në sigurim (në pronësi të vet, e marrë me qira, vendndodhja, sipërfaqja dhe dinamika e furnizimit të saj për lëshim në përdorim) dhe për pajisjen teknike që do të përdorë.

Specifikimi i formës së dorëzimit të dokumentacionit

Neni 3

(1) Kërkesës për dhënien e lejes për kryerje të punëve/veprimtarive të përfaqësimit në sigurim i bashkangjiten të dhënat për personin e autorizuar për kontakt me Agjencinë (emrin dhe mbiemrin, numrin e telefonit, posta elektronike).

(2) Dokumentacioni i dorëzuar me kërkesën për dhënien e lejes për aktivitetin/veprimtarinë për përfaqësim në sigurime, duhet të jetë origjinal ose i kopjuar por i vërtetuar nga një person i autorizuar (noteri), i firmosur nga personi i autorizuar ose nga organi kompetent, pa korrigjime të mëtutjeshëm, në gjuhën maqedonase dhe e njëjta nuk guxon të jetë më e vjetër se gjashtë muaj në ditën e dorëzimit të kërkesës për dhënien e lejes. Nëse dokumenti që duhet të dorëzohet është në një gjuhë tjetër, bashkë me dokumentin origjinal dorëzohet edhe forma e përkthyer në gjuhën maqedonase, e përkthyer nga një përkthyes i certifikuar dhe i vërtetuar në noter.

(3) Deklaratat dhe pyetësorët që janë pjesë e dokumentacionit që dorëzohet me kërkesën për dhënien e lejes për punë të përfaqësimit në sigurime, duhet të vërtetohen te personi i autorizuar (noteri) dhe të njëjtat nuk duhet të jenë më të vjetër se gjashtë muaj nga dita kur dorëzohet kërkesa për dhënien e lejes.

(4) Nëse legjislacioni i vendit nga ku vjen personi i huaj i cili synon të krijojë një kompani për përfaqësim në sigurim e rregullon ndryshe lëndën lidhur me dokumentacionin që dorëzohet me kërkesën për dhënien e lejes për kryerjen e punëve të përfaqësimit në sigurim, atëherë duhet të dorëzohet dokumenti i duhur, ose mendim juridik nga avokati me çka do të mund të vërtetohet dallimi i rregullativës, gjegjësisht do të sigurohet dokument tjetër me çka do të vërtetohet plotësimi i detyrimit të paraparë ligjor.

(5) Agjencia shqyrton dhe vendos për kërkesën për lëshimin e lejes për të kryer punë ose veprimtari të përfaqësimit në sigurim me dokumentacion të plotë. Me dokumentacionin e plotë nënkuptojmë dokumentacionin e përcaktuar me këtë rregullore, dokumentacionin i cili në mënyrë plotësuese kërkohet nga Agjencia, si dhe dokumentet, të dhënat dhe informatat e përshtatshme të cilat duhet të merren nga insitucionet kompetente vendore dhe të huaja në vend dhe jashtë tij.

Vendosja për kërkesën për marrjen e lejes për kryerjen e aktiviteteve/veprimtarive të përfaqësimit në sigurime

Neni 4

(1) Kur vendoset për kërkesën për dhënien e lejes për të kryer veprimtari të përfaqësimit në sigurime,

Agjencia vlerëson nëse janë përmbushur kushtet e parashikuara në Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve.

(2) Në bazë të vlerësimit nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve merr vendim për dhënien e lejes për kryerjen e veprimtarive/punëve të përfaqësimit në sigurim ose për refuzimin e kërkesës, brenda 60 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës me dokumentacion të plotë në përputhje me këtë rregullore.

Dispozitat përfundimtare

Neni 5

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejes për të kryer veprimtarinë e përfaqësimit në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 41/2011).

Neni 6

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën vijuese pas ditës së botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 2

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 37/2019)

Shtojca 1-Formulari K-MLP zëvendësohet me Shtojcën 1-Formulari K-MLP i cili i është bashkangjitur kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 3

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 37/2019)

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën vijuese pas ditës së botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

**KRYETAR I KËSHILLIT TË EKSPERTËVE
Klime Poposki**

AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË SIGURIMEVE



PËR MARRJEN E LEJES PËR KRYERJE TË VEPRIMTARIVE TË PËRFAQËSIMIT NË SIGURIME

1.	Emri dhe mbiemri, gjegjësisht titulli i personave që synojnë të themelojnë shoqëri/kompani të përfaqësimit në sigurim (citeten të gjithë themeluesit veçmas së bashku me përqindjen e aksioneve me të drejtë vote në kompaninë/shoqërinë për përfaqësim në sigurim)	
2.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
2.1.	Telefoni i personit të autorizuar	
2.2.	Adresa e postës elektronike e personit të autorizuar	
2.3.	Adresa e personit të autorizuar	

Kërkoj/më nga Agjencia për Mbiqëqyrjen e Sigurimeve të na japë leje për kryerjen e punëve/veprimtarive të përfaqësimit në sigurime në _____ (titulli/emri i propozuar i shoqërisë për përfaqësim në sigurime në themelim) me seli në rr. _____ nr. ____ në _____ (qytet).

Kërkesës i bashkangjit/bashknagjitem dokumentacionin e parashikuar në nenin 2 paragrafët (3), (4), gjegjësisht (3) dhe (5) të "Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm i cili dorëzohet me kërkesën për marrjen e lejes për kryerje të punëve të përfaqësimit në sigurime" siç janë (secili dokument radhitet veçmas)² :

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____

¹Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të Agjencisë për Mbiqëqyrjen e Sigurimeve. www.aso.mk. Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, domosdoshmërisht duhet të përdoret stilolaps dhe duhet të plotësohet me shkronja të mëdha.

²Dokumentacionin nga paragrafi (4) pika 8) nënparagrafët 8.3, 8.4 dhe 8.5, paragrafi (5) pikat 6) nënparagrafi 6.1, pika 9) nënparagrafët 9.2, 9.4 dhe 9.5 si dhe pikat 12) dhe 13) të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm i cili dorëzohet me kërkesën për marrjen e lejes për kryerjen e punëve/veprimtarive të përfaqësimit në sigurim, Agjencia do ta marrë me detyrë zyrtare nga organi publik kompetent (nëse i njëjti nuk dorëzohet nga kërkuesi), për të cilin kërkuesi do të bëjë një deklaratë që autorizon Agjencinë në emër të tij/saj dhe në llogari të tij/saj t'i përdorë të dhënat që përmbahen në këtë Formular dhe deri te Agjencia dorëzohet dëshmi për pagesën e kryer në llogarinë e institucionit përgjegjës për lëshimin e dokumentit të duhur në shumën e përcaktuar nga Tarifa e përcaktuar me ligj.

Vërtetimin nga neni 2 paragrafi (4) pika 4 të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm i cili dorëzohet me kërkesën për marrjen e lejes për kryerjen e punëve/veprimtarive të përfaqësimit në sigurim, Agjencia zyrtarisht do ta marr nga gjykata përkatëse kompetente (nëse i njëjti nuk paraqitet nga kërkuesi). Nëse personi është person i huaj, ai / ajo është i detyruar të sigurojë vetë informacionin e tillë nga autoritetet kompetente në vendin e huaj.

³Kërkesën e firmosin personat fizik ose përfaqësuesit e autorizuar të personave juridikë të cilët synojnë të themelojnë shoqëri për përfaqësim në sigurim.

DEKLARATË E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Me parashtrimin e kësaj kërkesë, Deklaroj që të dhënat dhe informacionet në këtë kërkesë, si dhe i gjithë dokumentacioni që i bashkangjes kërkesës për dhënie lejes për të kryer punë/veprimtari të përfaqësimit në sigurim, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara dhe në rast të ndryshimit të të dhënave të përfshira në këtë kërkesë, si dhe të dokumenteve të bashknagjitura me këtë kërkesë, për një afat kohor prej 3 ditëve të punës nga ndodhja e ndryshimit do ta njoftojë Agjencinë.

Me dorëzimin ose parashtrimin e kësaj kërkesë, unë jam dakord të përdoren të dhënat e mia personale të përfshira në këtë kërkesë në procedurën e realizimit të të drejtës sime pranë organeve kompetente për të marrë dëshmi dhe të dhëna të nevojshme nga institucionet e tjera në mënyrë zyrtare dhe të njëjtat të përdoren në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Data dhe vendi i dorëzimit

_____. ____ 20 ____

Nënshkrimi i parashtruesit të kërkesës³
